

# SMARTIA
## Sisteme Rrethimi & Porta

Building excellence every day



# Në ALUMIL ne ndërtojmë përsosmërinë çdo ditë!

Me më shumë se 30 vite eksperiencë, ALUMIL është një ndër kompanitë më të zhvilluara në të gjithë botën në dizajn , prodhim dhe shpërndarjen e sistemeve arkitekturale prej alumini. Misioni ynë është të përmirësojmë cilësinë e jetës së njerëzve duke rritur performancën e ndërtesave të tyre, me produkte të teknologjisë dhe estetikës së lartë.

Falë stafit tonë me eksperiencë, strukturave tona moderne të prodhimit dhe kontrollit të cilësisë, ne garantojmë performancë të lartë të produkteve tona dhe vlerë të shtuar.

Sistemet tona të rrethimit ashtu sikurse të gjithë seritë e OUTDOOR, janë zhvilluar në përputhje me vizionin e kompanisë për zgjidhje të jashtëzakonshme arkitekturale të cilësisë së lartë dhe teknologjisë së përparuar. Çdo zgjidhje e sistemeve të rrethimit përfshin një gamë të gjërë të përfitimeve dhe mund të kombinohet me të tjerë sisteme OUTDOOR ashtu dhe me sistemet e dritareve për një rezultat të jashtëzakonshëm.

## Përmbajtja


04 - 13
Hyrja

14 - 37
Sistemi Smartia FC80

38 - 47
Sistemi Smartia FC60

48 - 55
Sistemi Smartia FC10

56 - 89
Modelet e sistemeve të rrethimit

90 - 103
Materiale Dekorative



## Mendojmë globalisht, veprojmë lokalisht.

ALUMIL u themelua në vitin 1988 dhe është zhvilluar në një grup ndërkombëtar që përfshin:

| | |
|---|---|
| 32 | Filiale |
| 12 | Fabrika në Europë |
| 60 | Rrjet shitjesh në 60 vende të botës |
| 10.000 | Partnerë në të gjithë botën |

Përmes shumëllojshmërisë së gjërë të produkteve në sektorin e ndërtimeve, ALUMIL mbulon një gamë të gjërë të nevojave teknike dhe estetike, si në ndertesat private dhe në projekte ikonike në të gjithë botën. Portofoli ynë i produkteve përfshin sisteme për :

Dyer dhe dritare me hapje / Dritare me rrëshqitje
Dyer hyrëse / Dyer të palosshme
Grila dhe sisteme hijëzimi / Sisteme të varura
Fasada / Ndarëse të brendshme
Fleta polikarbonati / Atriume /
Kangjella dhe gardhe
Sisteme pergola / Zgjidhje për shtrime pishinash
Dyer rezistente ndaj zjarrit / Sisteme montimi
fotovoltaike / Barriera ndaj zhurmave



# Prodhim me cilësi dhe shërbim.

**Në ALUMIL, falë integrimit të lartë vertikal, ne kontrollojmë të gjitha proçeset e prodhimit në mënyrë që të sigurojmë produkte që dallojnë për cilësinë e tyre dhe karakteristikat teknike. Objektet tona industriale përfshijnë:**

- **11** Linja nxjerrje alumini me një kapacitet prej 100.000 ton
- **+** Laboratorë të ndryshëm të kontrollit të cilësisë
- **8** Linja të veshjes me pudër
- **1** Fabrikë prodhimi për profilet prej alumini me mbushje me shkumë
- **3** Linja për imitim të drurit dhe efekte speciale të ngjyrave
- **3** Impiante prodhuese për aksesorët
- **2** Fonderi për prodhimin e lingotave prej alumini me një kapacitet prej 80.000 ton
- **1** Fabrikë prodhimi për fletët e polikarbonatit
- **8** Linja montimi të ndarjeve termike
- **3** Impiante anodizimi
- **1** Fabrikë prodhimi për panele kompozite të përbëra prej alumini me një kapacitet prej 950.000 m²

# Krijoni hapësira spektakolare të jashtme, duke përdorur filozofinë e plotë të ALUMIL.

**Nëpërmjet sistemeve tona të rrethimit dhe zgjidhjeve të JASHTME, ALUMIL siguron mjetet më të vlefshme arkitekturale për dizenjimin e kopshteve dhe oborreve në rezidenca moderne, zona shplodhëse dhe ngrënieje në hotele, tarraca në restorante dhe shumë hapësira të tjera të hapura.**

**Më shumë se një listë e thjeshtë dhe tradicionale e zgjidhjeve arkitekturale, të gjitha seritë e OUTDOOR janë të karakterizuara nga standarte të larta dhe janë të kombinuara me njëra tjetrën, duke ofruar përmirësim të vazhdueshëm të ambienteve të jashtme. Është një grup i gjërë zgjidhjesh prej alumini, të personalizuara sipas dëshirës, për zbatimin e projekteve të shumta të ndërtimit.**



01 ▸ Veshje muri

02 ▸ Kangjella

03 ▸ Pergola Fikse

04 ▸ Shtrime pishinash

05 ▸ Pergola Bioklimatike

06 ▸ Sisteme rrethimi

## Avantazhet e zgjidhjeve OUTDOOR

/ Estetikë e përparuar dhe funksionim i shkëlqyer , për rehati dhe kushte jetese të jashtëzakonshme.

/ Inovacion dhe kreativitet, në përputhje me trendet arkitekturale moderne.

/ Fortësia, përmasa shumë të mëdha dhe nivele të larta të sigurisë.

/ Uniformiteti dhe përputhshmëria për zgjidhje të plota dekorative.

/ Nuk ka nevojë për mirëmbajtje, falë përdorimit të gjërë të aluminit.

/ Sisteme të integruara dhe mundësi shitjesh së tërthortë.



## Zgjidhni një nga tre seritë dhe rrethoni mjedisin tuaj sipas shijeve tuaja personale.

**ALUMIL ju mundëson tre tipe të sistemeve të rrethimit, secila prej tyre ka shumë karakteristika dhe avantazhe që i dallon në termat e instalimit të profileve mbushëse. Ata ofrojnë opsione të shumta për performancë të lartë të rrethimit dhe të dizenjimit të vendit tuaj në një mënyrë elegante.**

## SMARTIA
### FC80

FC80 mundëson një dizajn klasik me profilet e tij mbushëse të vendosuara midis shtyllave, me ose pa hapësira midis profileve mbushëse.
Në të njëjtën kohë, ofron një shumëllojshmëri të madhe të profileve, duke lejuar krijimin e dizajneve të panumërta dhe mbulimin e zgjidhjeve të shumta teknike, speciale ose jo.



FC80

## SMARTIA
### FC60

SMARTIA FC60 ka profilet e tij mbushëse të kapura horizontalisht në shtyllë, më së shumti në pjesën e jashtme, duke krijuar një dizajn totalisht linear përreth hapësirës suaj.
Zgjidhjet e portave janë të gjitha të përfshira.



FC60

## SMARTIA
### FC10

SMARTIA FC10 është një seri unike, me profilet mbushëse të montuara vertikalisht, duke ofruar një rezultat minimal të veçantë. Me një gamë të gjërë të profileve mbushëse prej alumini apo Woodalux, të vendosuar veçmas ose të kombinuara, seritë ofrojnë propozime dizajni të jashtëzakonshme.




FC10



## Zgjidhje dizajni të panumërta

Tri seri dhe nje zgjedhje e gjërë e profileve mbulojnë një gamë të gjërë të tipologjive dhe zgjidhjeve teknike dhe ofrojnë njëkohësisht propozime të panumërta dekorative me modele, materiale, ngjyra dhe zgjidhje ndriçimi të ndryshme etj.

## Estetikë e pamatshme

Dizajn i detajuar, shtylla alumini në vend të atyre prej betoni, pika fiksuese të fshehura, kapakë të veçantë, shumëllojshmëri materialesh dhe zgjedhjesh ndriçimi etj. Të gjithë këto së bashku janë një garanci për vlerë të lartë estetike.

## Përmasa shumë të mëdha

Një nga karakteristika diferencuese të këtyre sistemeve është aftësia e tyre mbivlerësuese. Lartësia totale e rrethimit dhe distanca midis shtyllave të njëpasnjëshme është më shumë se 2.0m, porta shtrihet në më shumë se 6.0m , në të dy rastet si të portave me rrëshqitje dhe atyre me hapje etj.

## Inovacion dhe diferencim

Nivele të larta të inovacionit, me teknika të reja, materiale të reja, kombinime inteligjente dhe ndërtime unike, të cilat ofrojnë diferencim dhe konkurrencë për partnerët tanë,  si sisteme rrethimi ose si pjesë e një kompleksi të JASHTËM.

## Qëndrueshmëri e lartë

Dizajni i veçantë i sistemeve, më së shumti lidhur me FC80, lejon ndërtime të larta dhe të forta. Të gjithë seritë janë shumë të qëndrueshme ndaj erërave të forta, madje dhe në raste të instalimit të profileve mbushëse pa hapësira (sipërfaqe të mbyllura).

## Rezistencë e lartë ndaj korrozionit

Jo vetëm karakteristikat e aluminit, por gjithashtu dizajni i veçantë dhe materialet që janë zgjedhur, garantojnë rezistencë ndaj kushteve të korrozionit (të instaluara në zona shkëmbore). Aksesorë prej çeliku ose aksesorë të bërë nga ekstrudimi i aluminit (ky luan një rol kyç në ruajtjen e bojës).



SMARTIA
FC80

## SMARTIA FC80 është një sistem rrethimi që vjen në forma dhe konfigurime të ndryshme.

Ofron një shumëllojshmëri zgjidhjesh të aplikueshme. Është një mjet me vlerë për çdo arkitekt, pjesë e çdo projekti dhe një përgjigje unike për kërkesa të ndryshme. Karakteristikat kryesore të një sistemi janë dekorative, duke futur stilin e mbushjes midis shtyllave dhe aplikimi i një game të gjërë të materialeve dekorative.

Për më tepër, sistemi dallohet për qendrueshmërinë e tij të pakrahasueshme – profile të përforcuara dhe paisje të rënda- që ndihmojnë lejimin e një distance të gjërë midis – shtyllave dhe krijimin e rrethimeve të mëdha private dhe të portave.

**Avantazhet**

- Nivelet më të larta të qëndrueshmërisë për ndërtimet në shkallë të gjërë, veçanërisht portat që bëjnë mjetet e transportit të kalojnë lehtësisht (më shumë se 6.0m).
- Mundësia e krijimit të sipërfaqeve pa hapësirë dhe për çdo problem që lidhet me ngarkesën e erës (më shumë se 2.0m lartësi)
- Gamë e gjërë zgjidhjesh dhe nivel të lartë personalizimi, falë bollëkut të profileve dhe zgjidhjeve teknike
- Nivele të larta inovacioni dhe diferencimi duke përdorur materiale të përparuar (Woodalux), korniza speciale të futura, mundësi të shumta ndriçimi etj.
- Zëvendësimi i – zakonisht i kërkuar – parafabrikimeve (kolona, sisteme hijëzimi) me sisteme rrethimi të integruara dhe profile pergola prej alumini.

# Detaje teknike



/ Profilet mbushëse prej alumini dhe të tjerë materiale të vendosura midis shtyllave, duke pasur pika fiksuese dhe kanale të fshehura të profileve. (01)

/ Shumëllojshmëri e tapave dekorative (piramid, trekëndësh ose stil i sheshtë) të disponueshëm në ngjyra që zgjasin gjatë (01)

/ Në mënyrë alternative, parmaku i posaçëm mund të ngjitet përmes gardhit, me vlefshmërinë e opsionit të ndriçimit. (02)

/ Bulona per kavalota dhe rozeta decorative pa pika fiksuese te dukshme. (03)



01



02



03

# Shtylla & kolona



Çdo nevojë teknike mund të mbulohet nga një gamë e gjerë shtyllash të madhësive dhe stileve të ndryshme që ndryshe nga betoni i zakonshëm mund të arrijnë:

- Konstruksione të mëdha
- Kombinime me panele me hapje, më shumë se 3.0m
- Me një shtrirje prej 2.0 m nga kolona në kolonë
- Funksionalitet i shkëlqyer dhe që zgjat shumë
- Zgjidhje të panumërta të personalizuara, ku duken shumë më bukur me profile prej alumini sesa prej betoni.



01



02



03



/ Kolonë 250x250mm, p.sh, trup çeliku apo betoni e rrethuar me profile prej alumini. (01)



/ Kolonë 120x120mm për gardhe si dhe për porta me rrëshqitje. (02)



/ Kolona minimale (p.sh, gjysmë) 40x80mm dhe 40x120mm, për inkuadrim mbi një shtyllë ekzistuese.



/ Kolonë 80x80mm, e thjeshtë ose me tipologji këndore, e kombinuar me tapa ose parmakë, me dizajn të veçantë dhe pika fiksuese të fshehura. (03)

SMARTIA

FC80 FC60 FC10

# Porta me hapje



Porta e oborrit tënd mund të jetë elegante dhe shumë funksionale!

SMARTIA FC80 është një sistem rrethimi i plotë dhe ofron zgjidhje të shumta për portat, veçanërisht në termat e estetikës elegante dhe dizajnit të fundit, duke siguruar qendrueshmëri dhe performancë. Përfshin porta të thjeshta me hapje për kalimin e përditshëm të njerëzve, që mund të kombinohet në harmoni me dy kanate me hapje për kalimin e mjeteve , me më shumë se 6.0m hapësirë.

Portat FC80 lejojnë shumëllojshmëri dizajni që mund të shkojnë përtej modeleve klasike, duke ruajtur qendrueshmërinë dhe funksionalitetin, veçanërisht falë gamës së gjerë të opsioneve të shtyllave, të dy tipet e hapjeve speciale dhe zgjidhjeve të ndryshme automatike mund të përfshijnë.

/ Hapjet pivot për kanate shumë të mëdha (më shumë se 3.0m), pa asnjë problem lirimi. Bashkëngjitur tek shtyllat, veçanërisht në ato 250mm, me rezultat të shkëlqyeshëm falë përbërjes prej metali. (01)

/ Hapjet cilindrike, të testuara në sistemet e dyerve të palosshme, të aplikuara në panelet normale dhe të mëdha të portave, operojnë pa probleme. (02)



01



02

# Portat me hapje



Seritë FC80 mundësojnë zgjidhje përfundimtare për portat me hapje me dizajn të avancuar dhe shumë detaje të zgjuara, të cilat ofrojnë vlerë të shtuar në produktin përfundimtar dhe garantojnë operim të butë dhe të gjatë.



/ Mekanizimi i hapjes i është bashkëngjitur një profili të veçantë tërthor për të shtuar më shumë fuqi nga problemet e lirimit dhe të dëmtimeve pas një periudhe të gjatë kohe.



/ Dorezë e integruar (si një alternativë për doreza klasike fikse), me ndriçim dhe opsione ngjyrash të ndryshme për dizajn unik.

/ Seleksionimi nga profilet dekorative fqinje dhe litarë të fuqishëm për mbushjen e hapësirave midis kornizave dhe kanateve.



01

/ Montim special në pjesën e sipërme të portës, që eleminon mundësinë e çfarëdo lloj dëmtimi në rast kapërcimi nga fëmijët ose këmbësorë të tjerë. (01)

# Portat me rrëshqitje



FC80 ofron një propozim të kompletuar për portat me rrëshqitje, të cilat mbulojnë hapësira për më shumë se 6.0m për kalimin e mjeteve dhe mund të kombinohen me porta me një kanat të vetëm për këmbësorët. Opsioni i dizajnit dhe funksionaliteti i lartë kujdesen për plotësimin e një game të gjerë të nevojave dhe përmirësimin e një rezultati estetik të përgjithshëm.

/ Ndërtimi mbështetës është bërë ekskluzivisht nga profile prej alumini në vend të blloqeve prej çementoje , për një ndjesi totale të aluminit.

/ Dizajn i veçantë që kompleton mbylljen dhe bllokimin e objektit, pa çekuilibrim nga ngarkesat e erës.

/ Përputhshmëri me mjete të avancuara për një operim të qetë automatik (motor, automatizim, etj.).

/ Profile të veçantë, të cilat kanë të fshehur mekanizimin e funksionimit, në pjesën e sipërme dhe të poshtme dhe mundësojnë një rezultat minimal shtesë.









# Profile mbushëse prej alumini



Sillni stilin e aluminit përballë shijeve tuaja personale.

Një zgjedhje domethënëse për materialet që do të përdoren midis shtyllave, është profili mbushës prej alumini, në një mënyrë që lejon dimensione të mëdha dhe ndërtime të forta. Bashkëngjitur horizontalisht apo vertikalisht ato arrijnë një rezultat të unifikuar dhe të jashtëzakonshëm.




/ Profile drejtkëndore prej alumini në përmasa të ndryshme (nga 15mm në 160mm) në mënyrë që të përdoren si sisteme rrethimi, në gjatësi normale dhe shumë të gjata (> 2.0m).




/ Mbivendosjet e profileve mbushëse prej alumini për krijimin e sipërfaqeve të mëdha dhe të fshehura me pak ose aspak hapësirë, duke u dhënë përparësi privatësisë së rezidentëve ndaj presionit të erës si një bonus.

# Materiale druri të përbëra



Mirëmbani estetikën e drurit, ndërkohë që përdorni materiale më të qëndrueshme.

Si një alternativë e drurit, që sjell një sërë disavantazhesh, të tilla si korrozioni, mirëmbajtja dhe gjatësi të vogla, sistemi SMARTIA FC80 ofron profilet mbushëse WOODEE, WOOPEE dhe WOODALUX, të gjitha të bëra prej druri të përbërë. Ata lejojnë ndërtime në përmasa të mëdha dhe karakterizohen nga qendrueshmëria unike, ndërsa japin një pamje të  mirë rafinuar që plotëson hapësirat e jashtme.



## WOODEE

Produkt i një cilësie të lartë, nga dru i virgjër (60%) me një profil rrethimi të disponueshëm në ngjyra dhe tekstura të ndryshme (“i sheshtë”, “Amazon”). Rezistent në mënyrë të pakrahasueshme, ajo ruan ngjyrën e saj dhe karakterizohet nga një pamje të drurit natyral.




## WOOPEE

Është një produkt i standarteve të larta i bërë nga dru i riciklueshëm (55-60%) me tre profile me sipërfaqe të stampuara dhe ngjyra të ndryshme. I përshtashëm për të dy sipërfaqet me ose pa hapësirë ( dërrasat e mbivendosura).




## WOODALUX

Woodalux është një produkt inovativ me atribute të shkëlqyera, siç është rezistenca, qendrueshmëria mekanike dhe ndjesia e drurit. E kombinuar me FC80, ju lejon ndërtime të përmasave të mëdha, p.sh, më shumë se 2.0m distanca midis shtyllave.

# Zgjidhje dekorative

Përveç sfidave të ndërtimit të një projekti, të cilat mund të plotësohen në total, FC80 ofron një grup të vlefshëm profilesh të veçantë. Këto profile sigurojnë liri krijuese, sepse lejojnë kombinime të pakufizuara dekorative të modeleve dhe materialeve. Sipërfaqja e gardhit përfshin një kompozim unik ku përfshihen elementë të ngulitur, korniza dekorative, materiale të ndryshme dhe krijimtari artistike.



## Zgjidhje të zgjuara teknike për kombinime të pakufizuara dekorative.



01



02



03



/ vija dekorative të tipit inoks, me përdorimin e profileve mbushëse 10 mm të mbivendosura, me shkëlqim dhe mat të anodizuar. (01)



/ profil shtesë i vendosur në mënyrë perimetrike për të krijuar korniza të bukura në hije të ndryshme (p.sh. inoks). (02)




/ profile speciale me dy kanale të ndryshme futëse në të dy anët, d.m.th. 3/25mm dhe 13/25mm, të cilat lejojnë kombinimin e sipërfaqeve dekorative (qelqi, druri, metali) në çdo pikë të panelit. (03)

/ profile përshtatës për shndërrimin e boshllëkut 25 mm në 3, 13 ose 14mm, për të futur materiale të ndryshme, si lustrim, fletë metalike, woodee etj. (03)

# Opsionet e ndriçimit



Zgjidhje të shumta të ndriçimit, të aplikuara në disa elemente strukturore të gardhit (shtylla, parmak, profile mbushëse, doreza) dhe të kombinuara në mënyrë të përshtatshme, mund të ofrojnë propozime unike dekorative që përmirësojnë estetikën e përgjithshme.



/ parmaku që është bashkangjitur në anën e sipërme të gardhit, jep mundësinë e ndriçimit përgjatë sipërfaqes së rrethimit.



/ profili i mbivendosur (40 mm) i kombinuar me dritare 20, 40 dhe 90mm, për sipërfaqet e fshehura me ndriçim të vazhdueshëm dhe të thyer.



/ dorezë e integruar në kanatin e derës, me mundësinë e ndriçimit të fshehur në të dy anët.



/ profil i veçantë që klikon në profilet e kanalit 25mm, duke ofruar shumë zgjidhje ndriçimi dekorativ.

## Portë me një hapje

- me sisteme rrethimi dhe shtyllë betoni ekzistuese
- gjysmë kolonë prej alumini 40x80 mm, profil i thjeshtë ngjitur



**Seksion**



**Detaje**





## Portë me rrëshqitje

- e mbështetur nga një kolonë prej alumini 120 mm (jo blloqe çementoje)
- me portë dhe gardh me hapje me një kanat (gjithçka në alumin)



**Seksion**



**Detaje**





## Portë me hapje të dyfishtë

- e mbështetur nga blloqe çementoje të mbuluara në anë me alumin 250 mm
- me portë me hapje me një kanat dhe gardhin përkatës (gjithçka në alumin)



## Portë me hapje të dyfishtë

- me profile mbushëse vertikale, me mëntesha rrotulluese të fiksuara në trarë çeliku e mbuluar tek anët prej alumini 250 mm (gjithçka në alumin).



**Seksion**



**Detaje**



**Seksion**



**Detaje**





SMARTIA
FC60

## SMARTIA FC60 është një sistem i plotë rrethimi prej alumini me profile mbushëse të zgjedhjes suaj të bashkëngjitur horizontalisht në shtylla.

Ajo ofron një rezultat të vazhdueshëm, minimal dhe estetikisht linear. Një sistem rrethimi që mund të azhornojë stilin e vendit tuaj dhe rekomandohet plotësisht për hotelet, rezidencat, ndërtesat e vogla, etj.

Ofron të gjitha opsionet e portave (të varura, rrëshqitëse) dhe karakterizohet nga qëndrueshmëri e lartë dhe dimensione të mëdha ndërtimi.

**Avantazhet**

- Dizajn i shkëlqyeshëm minimal / estetikë lineare, pa pika fiksuese të dukshme.
- Gamë e gjerë e zgjidhjeve dhe opsioneve të dizajnit, veçanërisht në profilet mbushëse prej alumini
- Kombinime unike me materiale druri të përbëra, të tilla si profile mbushëse hibride Woodalux.
- Fuqia dhe aftësia për hapësira të mëdha.
- Dizajn i veçantë që ofron lehtësi ndërtimi.

# Detaje teknike



SMARTIA FC60 kombinon në mënyrë efektive materiale të ndryshme dhe karakteristika teknike, dhe kështu, ofron zgjidhje të plota rrethimi për një grup të gjerë nevojash. Kolona të përforcuara, porta të forta, gamë të gjerë profilesh mbushëse prej alumini dhe materiale të tjera përbëjnë këtë seri, e cila përfshin estetikë lineare me performancë të lartë.

- / Shtylla prej alumini në formën "T", me kapak të thjeshtë ose perimetrik dhe pika fiksimi të fshehura.
- / I dizenjuar veçanërisht për vendosjen e bulonave për kavalota, në gjatësi të ndryshme dhe me një mbrojtje kundër ndryshkut.
- / Opsione të portës me hapje dhe rrëshqitje.
- / Përfundimi i profilit mbushës me profile të veçanta ose në mënyrë alternative me kapakë prej alumini ose plastike.







# Përzgjedhja e profileve mbushëse





SMARTIA FC60 ofron një gamë të plotë të profileve prej alumini dhe druri të përbërë për modelim kreativ, duke ruajtur estetikën e saj lineare. Profilet mbushës mund të bashkëngjiten me ose pa hapësirë, duke arritur rezistencë më të lartë ndaj ngarkesës së erës ose më shumë privatësi.

/ Profilet mbushëse WOODALUX, te kombinuara ose jo me ato prej alumini, krijojnë rezultate tërheqëse për sytë. Ato lejojnë gjatësi shumë të mëdha dhe krijojnë ndjesi natyrore prej druri, pa nevojë për mirëmbajtje.

/ Profile të ndryshme mbushëse prej alumini ose në seksione të thjeshta drejtkëndore (15-120 mm) ose ato me dizajn të veçantë (drejtkëndëshe, ovale, të mbivendosura).



## Portë me një hapje të vetme

- me pjesë të fiksuara dhe me sisteme rrethimi në pjesët ekzistuese të blloqeve të çementove.



## Portë me hapje të dyfishtë

- e mbështetur tek blloqet e çementos, të fshehura nga alumini 250 mm.
- me një portë me hapje të vetme dhe sistem rrethimi (çdo gjë prej alumini).



**Seksion**



**Detaje**



**Seksion**



**Detaje**





SMARTIA FC80 **FC60** FC10

# Portë me rrëshqitje

- e mbështetur nga kolona 120 mm prej alumini.
- të kombinuara me portë me hapje të vetme dhe sistem rrethimi (çdo gjë prej alumini).



**Seksion**



**Detaje**






Alumil SMARTIA FC10

# ALUMIL kompleton zgjidhjet e sistemeve të rrethimit me SMARTIA FC10, një sistem që karakterizohet nga këto linja vertikale dhe për pasojë nga estetikë absolutisht minimale.

Në të njëjtën kohë, ky sistem mund të zëvendësojë me sukses konstruksionet e ngjashme lineare prej çeliku , pa pasur probleme të veshjes, korrozionit dhe mirëmbajtjes që shoqërojnë këto të fundit.

**Avantazhet**

- Stili i veçantë, nuk e gjejmë zakonisht në sisteme rrethimi prej alumini.
- Rezultat final spektakolar kur kombinohet me profile WOODALUX.
- Zëvendëson në mënyrë efektive ndërtimet respektive prej çeliku.
- Ndërtime te gjata të sistemeve të rrethimi pa probleme të qëndrueshmërisë dhe ngarkesës së erës.
- Mënyrë inteligjente dhe efektive e lidhjes së profileve mbushëse - veçanërisht në anën e sipërme - gjë që nuk vihet re.



# Detaje Teknike

SMARTIA FC10 përfshin disa karakteristika teknike dhe kur kombinohet me sisteme të tjerë, ajo mbulon një gamë të gjerë zgjidhjesh dhe aplikimesh, duke mbetur estetikisht e pakrahasueshme dhe duke performuar në mënyrë efektive në të gjitha nivelet.

/ Mbështetja e profileve mbushëse në fund është arritur duke përdorur një kangjellë prej alumini e dizenjuar specifikisht (kangjellë), duke pasur pikat fiksuese të fshehura të profileve mbushëse.

/ Mbështetja në anën e sipërme arrihet ose me parmak me opsion drite LED, ose me kapakë të krijuar posaçërisht që mbajnë mbështetjen pa u vërejtur.

/ Për zgjidhjet e portave me hapje ose me rrëshqitje, profilet mbushëse të FC10 kombinohen me profilet e SMARTIA FC80.





# Zgjedhja e profileve mbushëse

Pavarësisht thjeshtësisë së tij, SMARTIA FC10 ofron një shumëllojshmëri të profileve mbushëse vertikale të bashkangjitura, të cilat krijojnë një gardh që ka një vlerë të madhe qendrueshmërie dhe estetike.

/ Një gamë e gjerë e profileve mbushëse të përforcuara prej alumini në disa seksione kryq, të tilla si dritarja e tipit "Z" e cila bllokon shikimin në të dy mënyrat për më shumë privatësi.

/ Të gjitha profilet mbushëse WOODALUX, në sajë të dizajnit të tyre të veçantë (trashësia, dalja e vidhosjes) e bëjnë këtë lloj gardhi tepër të fortë.

/ Rekomandohet bashkëngjitja e njëkohshme e profileve mbushëse me prerje të ndryshme dhe në kënde të ndryshme. Për më tepër, kombinimi i aluminit dhe WOODALUX ofron krijime estetikisht të pakrahasueshme.

/ Profil special "i verbër" që jep një rezultat të stilit të Barkodit dhe mund të kombinohet me zgjidhje të ngjashme të veshjes.







## Portë teke dhe dopjo

- me shtylla 250 mm dhe 120 mm.
- sisteme rrethimi me profil prej alumini dhe WOODALUX (32x80 mm)



## Portë me rrëshqitje me një kanat të vetëm

- me profile mbushëse të stilit “barkod” dhe shtylla 120 mm.
- sisteme rrethimi me profile mbushëse në formë “Z-je”.



**Seksion**



**Detaje**





**Seksion**



**Detaje**





**Seritë**
# FC80

**Kodi**
# 8001

- Profil mbushës mbivendosës 90 mm për panel të fortë, të mbyllur. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve te kanateve.



8001 - D



8001 - F



8001 G — Portë me kanat-tek
A — Portë me kanat-tek me konstruksion të fiksuar
D — Portë me dopio-kanat
S — Portë me rrëshqitje
F — Sisteme rrethimi

**Seritë**
# FC80

**Kodi**
# 8003

- Profil mbushës mbivendosës 90 mm në drejtim vertikal për krijimin e një paneli të fortë, të mbyllur. Përdorimi i një traverse horizontale për dizajn dhe më shumë vertikale bazuar në dimensionet e kanateve.



8003 - D



8003 - F



8003 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8005

- Profil mbushës mbivendosës 90 mm në fund dhe profil mbushës drejtkëndor 80 mm sipër, me hapësirë të barabartë. Të dy sipërfaqet janë të ndara me një profil traverse.



8005 - D



8005 - F



8005 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8007

- Përdorimi i profileve drejtkëndore në të dy sipërfaqet e modelit. Sipërfaqja e verbër është me profile mbushëse me lartësi 120 mm. Profilet e tjera mbushëse janë në lartësi 60 mm me ndarje te njëjtë në hapësirë.



8007 - D



8007 - F



8007 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8009

▸ Përdorimi i profileve drejtkëndore 60 mm, me ndarje të njëjtë në mes. Hapësira në majë është 240 mm.



▸ 8009 - D



▸ 8009 - F



▸ 8009 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8011

▸ Të gjithë profilet mbushëse kanë gjatësi 40 mm. Gjerësia e pjesës së hapësirës është 30 cm.



▸ 8011 - D



▸ 8011 - F



▸ 8011 G A D S F

Seritë

# FC80

Kodi

# 8013

- Vendosja e një profili mbushës drejtkëndor 120 mm me hapësirë 30 mm. Përdorimi i një profili travers horizontal dhe vertikal për dizajn dhe forcim.



8013 - D



8013 - F



8013 G A D S F

Seritë

# FC80

Kodi

# 8015

- Vendosja vertikale e profileve mbushëse 40 mm, drejtkëndore sipër dhe të mbivendosura në fundin e nje sipërfaqeje "të verbër" dhe përdorimi i traversës shtesë, në varësi të dimensioneve të kanateve.



8015 - D



8015 - F



8015 G A D S F

Seritë **FC80**

Kodi **8017**

- Përdorimi i profileve mbushëse mbivendosëse 90 mm, të kombinuar me 4 shirita dekorativë vijues d.m.th., anodizim natyral. Përdorimi i traversës shtesë, i cila varet nga dimensionet e kanateve.



8017 - D



8017 - F



8017 G A D S F

Seritë **FC80**

Kodi **8019**

- Përdorimi i profileve mbushëse 90 mm, kombinuar me profile dekorative në skaje, p.sh., anodizim natyral. Përdorimi i traversës shtesë, varet nga dimensionet e kanateve.



8019 - D



8019 - F



8019 G A D S F

Seritë
# FC80

Kodi
# 8021

- Sipërfaqja prej alumini me profilet mbushëse të mbivendosura 90 mm dhe dritare me përbërje druri premium Woodee . Korniza dekorative me opsionin me dy ngjyra (anodizimi) dhe përdorimi i profileve shtesë traversë, varen nga dimensionet e kanateve.



8021 - D



8021 - F



8021 G A D S F

Seritë
# FC80

Kodi
# 8023

- Sipërfaqja prej alumini me profile mbushëse mbivendosëse 90 mm dhe dritare të veshura me fletë alumini me vrima 40 cm. Korniza dekorative me opsionin me dy ngjyra (anodizimi) dhe përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



8023 - D



8023 - F



8023 G A D S F

Seritë

FC80

Kodi

8025

▸ Krijimi i një rrjeti me tre ose më shumë pjesë në lartësinë e kornizës së kanateve. Profilet e drurit të përbërë Woopee 130-150 mm. Kornizë perimetrike me opsionin me dy ngjyra (anodizimi).



▸ 8025 - D



▸ 8025 - F



▸ 8025 G A D S F

Seritë

FC80

Kodi

8027

▸ Me profile mbushëse të mbivendosur prej alumini 90 mm për sipërfaqen e verbër dhe Woodee 120 mm me hapësirë të vogël (- 3 cm). Përdorimi i profileve shtesë të trasversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



▸ 8027 - D



▸ 8027 - F



▸ 8027 G A D S F

**Seritë**
# FC80

**Kodi**
# 8029

- Me profile mbushëse prej alumini të mbivendosur 90 mm për sipërfaqen e verbër dhe fletë prej alumini të shpuar tek skajet. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, të cilët varen nga dimensionet e kanateve.



- 8029 - D



- 8029 - F



- 8029 G A D S F

**Seritë**
# FC80

**Kodi**
# 8031

- Profile mbushëse prej alumini të mbivendosur 90 mm për sipërfaqen e verbër dhe Woodee 120mm me hapësirë të vogël (- 3cm). Përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



- 8031 - D



- 8031 - F



- 8031 G A D S F

**Seritë** FC80

**Kodi** 8033

- Me profile mbushëse drejtkëndore 120 mm dhe 40 mm, të vendosura në një model të veçantë dhe hapësira të ndryshueshme. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



- 8033 - D



- 8033 - F



- 8033 G A D S F

**Seritë** FC80

**Kodi** 8035

- Me profile mbushëse drejtkendore 120 mm, 60 mm dhe 25 mm, të vendosura në modele të veçanta dhe hapësira standarte 25mm. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, varet nga dimensionet e kanateve.



- 8035 - D



- 8035 - F



- 8035 G A D S F

**Seritë** FC80

**Kodi** 8037

- Me profile mbushëse drejtkëndore 120 mm dhe 60 mm të vendosura vertikalisht, në modele të veçanta dhe hapësira të ndryshueshme.



8037 - D



8037 - F



8037 G A D S F

**Seritë** FC80

**Kodi** 8039

- Vendosja horizontale e mbivendosjeve të profileve mbushëse 90 mm dhe dy linjave me profile mbushëse 40 mm me distancë të barabartë në pjesën e poshtme. Përdorimi i profilit shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



8039 - D



8039 - F



8039 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8041

- Profilet mbushëse mbivendosëse të vendosura horizontalisht 90 mm dhe dy linja me profile mbushëse 40 mm me hapësira të ngjashme. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, varen nga dimensionet e kanateve.



- 8041 - D



- 8041 - F



- 8041 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8043

- Profilet mbushëse të mbivendosura të vendosura horizontalisht 90 mm dhe fletës së aluminit me vrima. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, varen nga dimensionet e kanateve.



- 8043 - D



- 8043 - F



- 8043 G A D S F

**Seritë** FC80

**Kodi** 8045

- Panele druri të përbërë 90 mm dhe 2 + 1 Woopee 150 mm të mbivendosura horizontalisht. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



- 8045 - D



- 8045 - F



- 8045 G A D S F

**Seritë** FC80

**Kodi** 8047

- Profilet mbushëse Woopee 130 mm prej druri të përbërë, vendosen horizontalisht duke krijuar një sipërfaqe të verbër. Përdorimi i profileve shtesë të traversës në varësi të dimensioneve të kanateve.



- 8047 - D



- 8047 - F



- 8047 G A D S F

**Seritë**

## FC80

**Kodi**

## 8049

- Me profile mbushëse Woopee 130 mm nga druri i përbërë, të vendosur sipër me hapësirë 50 mm, përdorimi i profileve shtesë të traversës, varen nga dimensionet e kanateve.



- 8049 - D



- 8049 - F



- 8049 G A D S F

**Seritë**

## FC80

**Kodi**

## 8051

- Profilet mbushëse Woopee 130 mm prej druri të përbërë ,të vendosura horizontalisht dhe përdorimi i profileve shtesë te traversës, varen nga dimensionet e kanateve.



- 8051 - D



- 8051 - F



- 8051 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8053

- Vendosja horizontale e profileve mbushëse mbivendosëse 90 mm dhe tre shufra prej druri të përbërë Woodee 150 mm. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve të kanateve.



8053 - D



8053 - F



8053 G A D S F

**Seritë**

# FC80

**Kodi**

# 8055

- Profile mbushëse drejtkëndore prej alumini 80 mm, të vendosura vertikalisht me hapësirë të ngjashme.



8055 - D



8055 - F



8055 G A D S F

Seritë
# FC60

Kodi
# 6001

- Profile mbushëse prej alumini 40 mm, të vendosura horizontalisht me hapësirë të ngjashme në mes. Përdorimi i profileve shtesë te traversës, varen nga dimensionet e kanatit.



6001 - D



6001 - F



6001 G A D S F

Seritë
# FC60

Kodi
# 6003

- Me profile mbushëse prej alumini 80mm dhe Woodalux 40x32 mm, të vendosura horizontalisht me një hapësirë prej 10mm në mes. Përdorimi i profileve shtesë të traversës, në varësi të dimensioneve te kanateve.



6003 - D



6003 - F



6003 G A D S F

Seritë

# FC60

Kodi

# 6005

- Me profile mbushëse prej alumini 120 mm dhe 40 mm, të vendosura në një hapësirë prej 40 mm. Përdorimi i profileve shtesë të traversës,varet nga dimensionet  e kanateve.



- 6005 - D



- 6005 - F



- 6005 G A D S F

Seritë

# FC10

Kodi

# 1001

- Me profile të portave FC80 dhe duke përdorur profile speciale të dizejnuara me barkod.



- 1001 - D



- 1001 - F



- 1001 G A D S F

Seritë

## FC10

Kodi

## 1003

- Me profile portash FC80 dhe profile mbushëse prej alumini 35x80 mm, të vendosura në kënde specifike.



- 1003 - D



- 1003 - F



- 1003 G A D S F



WOODALUX është një produkt inovativ i bazuar në profile prej alumini të mbuluara me dru të përbërë të cilësisë së lartë. Në përgjithësi, është ideal për mbrojtje nga drita dhe aplikime dekorative, pergola dhe sisteme rrethimi (profile mbushëse), duke siguruar një stil natyral afatgjatë në ndërtesa dhe ndërtime të jashtme.

- Qëndrueshmëri mekanike e përforcuar që lejon gjatësi të larta pa u thyer ose përkulur (deri në 3.0m).
- Rezistencë e çertifikuar ndaj kushteve të rënda të motit dhe faktorëve të dekompozimit të drurit (kripësia, insektet, dekompozimi).
- Ruajtja e ngjyrave, edhe në ekspozimin e saj në diell, pa rrezikun e zbehjes së ngjyrës.
- Ruajtja, veshja me pudër ose lloje të tjera të punës së mirëmbajtjes nuk kërkohen, në kundërshtim me drurin.
- Gamë e gjërë e profileve, ngjyrave dhe zgjidhjeve.
- Nivele të larta të estetikës, inovacionit dhe diferencimit nga ndërtime të ngjashme.





| | |
|---|---|
| E BARDHË | 11 |
| DRU | 31 |
| PALISANDER | 29 |
| DRU ARRE | 28 |
| WENGE | 26 |
| GRI E HAPUR | 22 |
| GRI E MBYLLUR | 25 |
| KORAL | 08 |



120x25mm



60x32mm



120x32mm



80x32mm



40x32mm



90x25mm



WOODEE është një produkt i cilësisë së lartë që konsiston në dru të përbërë (60% dru i virgjër), ideal për stolisje, rrethim dhe veshje të hapësirave të jashtme. I përshtatshëm për profile rrethimi 12x120mm është i kombinuar me alumin, duke lejuar dizajne të pakufizuara, estetikisht të shkëlqyera. Idealisht, një sistem rrethimi WOODEE është i kombinuar me kuvertë dhe veshje, duke mundësuar një rezultat të përgjithshëm që tregon rezistencë që zgjat dhe stil të shkëlqyer.

- Ndjesia e drurit natyral, pa disavantazhet e kalbjes dhe mirëmbajtjes.
- Rezistencë e çertifikuar dhe ruajtja e ngjyrave në kushtet ekstreme të motit.
- Zgjidhje të pakufizuara të projektimit prej druri-alumini.



/ I vlefshëm në ngjyra të ndryshme







WOOPEE është një produkt i përbërë prej druri për zbukurime, aplikime për veshje, me 55 - 60% dru nga burime të ricikluara. Ai ruan atributet natyrore dhe përparësitë e drurit, ndërsa në të njëjtën kohë eliminon problemet e kalbjes. Në përgjithësi, është në dispozicion në katër opsione ngjyrash dhe në një grup profilesh, tre prej të cilave janë më të përshtatshmet për tu përdorur si sistem rrethimi.

- Shumëllojshmëri zgjidhjesh të profileve, ngjyrave dhe aplikimeve.
- Aplikime të gjata, veçanërisht në rastet e profileve të mbivendosura.
- Krijime të avancuara dhe stili, kur kombinohen me alumin.
- Shumë rezistente ndaj kushteve të motit.

/ E vlefshme në ngjyra të ndryshme











130x13mm



130x25mm



150x25mm

# Siperfaqet e xhamit



Përveç profileve mbushëse prej alumini dhe produkteve të qëndrueshme të përbërë nga druri, SMARTIA FC80 lejon ngjitjen e elementëve xham për ndërtimin e sistemeve të rrethimit modern. Zgjidhjet me dizjan mund të krijohen nga shtimi i lustrimeve me ngjyra, tekstura dhe modele dekorative të ndryshme.

Me përdorimin e traversës dhe të profileve të tjera speciale, panelet e xhamit mund të vendosen ose në anët e portës ose në çdo pike të sipërfaqes së tij.



/ Instalimi i xhamave me përdorimin e një profili special i cili shkurton boshllëkun nga 25mm në 13mm.



/ . Profil special për vendosje të "rastësishme" të xhamave midis profileve mbushëse prej alumini.

# Kangjella prej xhami



Falë dizajnit dhe qëndrueshmërisë së tij unike, sistemi i rrethimit SMARTIA FC80 mund të përdoret gjithashtu si një aplikim për kangjella. Përveç kësaj, shumëllojshmëria e profileve lejon zgjidhje të shumta teknike, të tilla si sistemet e ndarjes së ballkoneve për estetikë të lartë, veçanërisht kur alumini dhe druri i përbërë kombinohen



# Fletë metalike dekorative



Zgjidhjet dekorative për gardhet dhe panelet e portave plotësohen me fletë alumini, të vrimëzuara ose jo. Ata krijojnë sipërfaqe të mëdha pa nyje si në rastin e profileve mbushëse, duke ulur koston pa cenuar estetikën dhe funksionimin e produktit.

Prodhimi është i lehtë dhe zgjidhjet e dizajnit janë të pafundme. Kështu, ato japin zgjidhje të personalizuar dhe të përparuar përsa i përket stilit. Instalimi i tyre është gjithashtu i lehtë, falë profileve speciale me hendek 3.2 mm. Zgjidhjet dekorative janë të pafundme, duke ofruar zgjidhje elegant dhe të personalizuara.







# Cilësi e lartë, opsione të pafundme ngjyrash.

Sistemet e rrethimit zakonisht janë të ekspozuara ndaj kushteve të ndryshme të korrozionit (moti, zonat bregdetare, e.t.j.) kështu, ALUMIL, si një kompani pioniere, kombinon veshjen jashtëzakonisht të qëndrueshme të Klasës Bregdetare me trajtimin e veçantë sipërfaqësor të para-anodizimit dhe zvogëlon dukshëm korrozionin.

# Para-anodizim, mbrojtja e vërtetë anti-korrozion.

Kombinoni para-anodizimin me ngjyra të panumërta, duke krijuar zgjidhje arkitektonike që zgjasin, me një stil dhe cilësi të pakrahasuar.

- RAL 6009 Structura YK309F
- RAL 8014 Structura YM314F
- GRIS 2150 Sable YW365F
- RAL 7021 Structura YL321F
- RAL 9007 Structura Y2329F
- RAL 1013 Structura YD313F
- 522 Sahara Shade
- 815 Mesogeios Crete

**Tabela e ngjyrave me pudrat e qëndrueshmërisë së lartë**

- RAL 7034 Structura YL334F
- RAL 3005 Structura YG305F
- RAL 7016 Structura YL316F
- RAL 9010 Structura YA310F
- RAL 7012 Structura YL312F
- RAL 7015 Structura YL315F
- RAL 6005 Structura YK305F
- 801 MesogeiosCorsica

## ALBANIA

High-Way
Tiranë – Durrës km 7, Albania
Tel: +355 48 240 230
Fax: +355 48 240 234
E-mail: info.al@alumil.com

## THESSALONIKI
## HEAD OFFICES & SHOWROOM

Gogousi 8, Efkarpia
Thessaloniki - GR 564 29
Tel.: +30 2313 011000
Fax: +30 2310 692473
E-mail: info@alumil.com

## HEADQUARTERS

Kilkis Industrial Area
Kilkis - GR 61100
Tel.: +30 23410 79300
Fax: +30 23410 71988
Email: info@alumil.com


www.alumil.com